



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P. 726/2015**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.12.2015 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** “Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-06670-08-18-2015, me objekt “Rehabilitimi i bregut të Liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës së segmentit Lin – Pogradec”, me fond limit 164.998.901 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Banka Botërore).

Zhvillim jo i rregullt i procedurës së mësipërme të prokurimit”.

**Ankimues:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k.  
Rr. “Muzakët”, Pallati Vokshi, Kati VII, Tiranë

**Autoriteti kontraktor:** Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Rruga “Sami Frashëri”, Nr.10

**Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I


#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.08.2015 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-06670-08-18-2015, me objekt “Rehabilitimi i bregut të Liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës së segmentit Lin – Pogradec”, me fond limit 164.998.901 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 17.09.2015 është zhvilluar procedura e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar klasifikimit përfundimtar të datës 06.11.2015, kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k.  
& “Geci” sh.p.k. 128.639.120 lekë, kualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bajrami N” sh.p.k.  
& “Al-MexWood” sh.p.k. & “Eurondërtim 2000” sh.p.k.  
143.410.832 lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k.  
& “Garden Line” sh.p.k. & “Gjiguria” sh.p.k. 163.087.646 lekë, kualifikuar

4. “Gjoka Konstruksion” sh.p.k.	164.767.690 lekë, skualifikuar
5. “A.N.K.” sh.p.k.	164.789.829 lekë, skualifikuar
6. “Fusha” sh.p.k.	164.872.565 lekë, kualifikuar
7. “B 93” sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
8. “Çausi M” sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
9. “Rosi” sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.3. Në datën 06.11.2015 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si edhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 09.11.2015 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.

Ankimuesi ngre pretendimet si më poshtë vijon:

[...]

*Në datën 07.10.2015, u njoftuam nëpërmjet sistemit elektronik për klasifikimin përfundimtar të ofertave të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në të cilën renditeshim në vend të parë.*

*Referuar LPP dhe rregullave të prokurimit publik, operatorët ekonomikë kanë të drejtën e ankimit mbi vendimin e dhënë brenda 7 ditëve kalendarike. Thënë ndryshe, afati përfundimtar i ankesave në AK ka skaduar më datë 15.10.2015.*

*Bazuar në nenin 63, pika 5 dhe 6 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, AK është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 7 ditëve kalendarike (afati maksimal datë 23.10.2015), në të kundërt operatori ekonomik ka të drejtë të ankohet në KPP, brenda 10 ditëve me skadimin e afatit të përcaktuar më sipër.*

*Ky afat ka skaduar më datë 02.11.2015. deri në këtë datë nuk ka pasur asnjë njoftim në portalin [www.kpp.gov.al](http://www.kpp.gov.al), për ankesa të depozituara për procedurën e mësipërme të prokurimit.*

*Rrjedhimisht me skadimin e afateve të mësipërme AK është i detyruar të njoftojë fituesin e procedurës së mësipërme të prokurimit, bazuar mbi vendimin e KVO, dhënë nëpërmjet sistemit elektronik në datë 07.10.2015.*

*Por në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore të sipërcituara, më datë 06.11.2015, nëpërmjet sistemit elektronik u njoftuam për një ndryshim në renditje, duke kualifikuar bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.*

*Vendimi i mësipërm i marrë nga titullari i AK rezulton që jo vetëm është marrë në kundërshtim me afatet ligjore të përcaktuara më sipër, por edhe në kundërshtim me kriteret për kualifikim, për të cilat komisioni i vlerësimit të ofertave kishte dhënë vendimin e skualifikimit të tij.*

*[....] Ju bëjmë me dije se bashkimi i mësipërm i operatorëve ekonomikë është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e dhëna në dokumentat e tenderit, pasi sipas informacioneve që ne disponojmë nuk ka paraqitur, i mungojnë ose nuk plotëson një sërë kriteresh ligjore dhe teknike si më poshtë vijon:*

1. Pikën 2.1.d. (nuk janë paraqitur Formular Vlerësimi sipas Shtojcës 8);
2. Pikën 2.1.dh. (nuk është paraqitur Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9);

3. *Pikën 2.1.e. Referuar Vendimit të ERE-s, nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë, neni 9/1, përcaktohet termi “detyrim i maturuar”. Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv) si edhe kur është rasti, kamatvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar”. Konsulto qëndrimin e mbajtur nga KPP në të gjitha vendimet dhëna [...]*
4. *Pikën 2.3.2. (nuk janë paraqitur bilancet për tre vitet e fundit 2012, 2013, 2014);*
5. *Pikën 2.3.4. (nuk janë paraqitur taksat vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas QKR);*
6. *Pikën 2.4.2.;*
7. *Pikën 2.4.3. (stafi i paraqitur nuk është në përputhje me punimet e mara përspiër nga secili operator dhe nuk është i regjistruar në kompaninë respektive. Mungojnë diplomat, kontratat e punës dhe CV)*
8. *Pikën 2.4.5. (makineritë e pajisjet e paraqitura nuk janë në përputhje me punimet e marra përsipër nga secili operator. Makineritë e mara me qera nuk mbulojnë periudhën e realizimit të objektit të prokurimit. Nga informacioni që disponojmë operatori nuk disponon makineri hidrombjellje si dhe një sërë makinerish të tjera të kërkuara në DST).  
Si përfundim kërkojmë ndërhyrjen nga ana juaj në cilësinë e titullarit të AK duke skualifikuar bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë dhe vijimin e procedurës me njoftimin e fituesit sipas vendimit të KVO datë 07.10.2015*

II.5. Operatori ekonomik ankimues sqaron se në datën 19.11.2015, me shkresën nr. 2055/2 prot., datë 16.11.2015, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit duke e refuzuar ankesën.

II.6. Në datën 23.11.2015 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komsionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar pretendimet si më poshtë vijon:  
[...]

*Klasifikimi për procedurën e mësipërme është dhënë në datën 07.10.2015, dhe klasifikimi i dytë në datën 06.11.2015. AK në asnjë rast nuk mund të zgjasë afatet ligjore të sipërcaktuara përveç rasteve të pezullimit të tyre për forca madhore etj. por në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore më datë 06.11.2015, nëpërmjet sistemit elektronik u njoftuam për një ndryshim në renditje duke u kualifikuar bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.*

*Në datë 19.11.2015, kemi marrë përgjigjen në lidhje me ankimin që kemi bërë, në shkelje të afatit 7 ditor që neni 63/5 parashikon. Pra autoriteti kontraktor e ka nisur shkresën në datën 18.11.2015 (e vërtetuar nga zarfi bashkëngjitur) duke mos respektuar afatet ligjore, të cilat i shërbejnë gjithashtu dhe transparencës së procesit. Autoriteti kontraktor kishte detyrimin të na njoftonte jo më vonë se dt. 17.11.2015.*

*[...] Fondi Shqiptar i Zhvillimit nuk mund të kryejë një vendimmarrje të tillë pa respektuar afatet dhe pa arsyetuar vendimet.*

[...]

*Lidhur me themelin e çështjes bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e dhëna në dokumentat e tenderit pasi nuk ka paraqitur, i mungojnë ose nuk plotëson një sërë kriteresh ligjore dhe teknike si më poshtë vijon:*

- 1. Rezulton se subjektet “Curri” sh.p.k. dhe “Geci” sh.p.k. nuk kanë paguar detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për muajin korrik 2015, i cili ka pasur datë të fundit të pagesës 31.08.2015.*
- 2. Bashkimi i mësipërm i operatorëve ekonomikë nuk plotëson kapacitetin teknik për mjetin special “makineri hidrombjellje”, që do të thotë që nuk kanë një kontratë të vlefshme që plotëson kushtet ligjore të kontratës dhe specifikimet teknike në përputhje me punën që do të kryejë.*
- 3. Po kështu dyshojmë në mënyrë të arsyeshme se nuk janë paraqitur taksat vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas QKR;*
- 4. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk disponojnë mjetet në përputhje me punën që kanë marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.*
- 5. Gjithashtu stafi i paraqitur nuk është në përputhje me punimet e mara përsipër nga secili operator dhe nuk është i regjistruar në kompaninë respektive. Mungojnë diplomat, kontratat e punës dhe CV.*
- 6. Po kështu dyshojmë në mënyrë të arsyeshme se nuk janë paraqitur formularët e vlerësimit sipas shtojcës 8;*
- 7. Nuk është paraqitur deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas shtojcës 9; nuk janë paraqitur taksat vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas QKR;*

*[...]*

- Të pranojë ankesën e paraqitur nga ana jonë dhe të skualifikojë bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nga kjo procedurë e prokurimit pasi nuk plotëson kushtet për kualifikim të dhëna në dokumentat e tenderit.*
- Detyrimin e AK:*
  - Të anullojë vendimin e datës 06.11.2015, në të cilën kualifikohet bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.*
  - Për lënien në fuqi të vendimit të datës 07.10.2015, të KVO*
  - Të vijojë procedurën me njoftimin e fituesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k.*

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 2151/2 prot., datë 25.11.2015, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, protokolluar me tonën në datën 25.11.2015 me nr. 1777/2 prot., është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton si më poshtë vijon:

*Në datën 17.09.2015 është zhvilluar procedura e prokurimit dhe në datën 07.10.2015 nëpërmjet sistemit elektronik ofertuesit janë njoftuar për klasifikimin përfundimtar, i cili rezulton si më poshtë:*

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k.  
& “Geci” sh.p.k. 128.639.120 lekë, skualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bajrami N” sh.p.k.  
& “Al-MexWood” sh.p.k. & “Eurondërtim 2000” sh.p.k.  
143.410.832 lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k.  
& “Garden Line” sh.p.k. & “Gjiguria” sh.p.k. 163.087.646 lekë, kualifikuar
4. “Gjoka Konstruksion” sh.p.k. 164.767.690 lekë, skualifikuar
5. “A.N.K.” sh.p.k. 164.789.829 lekë, skualifikuar
6. “Fusha” sh.p.k. 164.872.565 lekë, kualifikuar
7. “B 93” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
8. “Çaushi M” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
9. “Rosi” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Në datën 12.10.2015 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Geci” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k. paraqiti ankimim pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit.

Në datën 16.10.2015 autoriteti kontraktor i ktheu përgjigje ankimesit duke e pranuar ankesën.

Në datën 20.10.2015 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, mbështetur në Vendimin e Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesave vendosi të konsiderojë të kualifikuar bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.

KVO bëri kontrollin e veprimeve aritmetike të preventivit dhe konstatoi se nuk ka gabime aritmetike. Më pas KVO kontrolloi për oferta anomalisht të ulta.

[...]

KVO me unanimitet vendosi të njoftojë bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. të paraqesin argumentimet për ofertën anomalisht të ulët të paraqitur në tender.

Në datën 05.11.2015 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrtoi argumentimet e paraqitura nga bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. dhe konstatoi se argumentat e dhëna janë të mjaftueshme.

Pas rivlerësimit, në datën 06.11.2015 është dhënë rezultati përfundimtar i kualifikimeve si më poshtë vijon:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k.  
& “Geci” sh.p.k. 128.639.120 lekë, kualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bajrami N” sh.p.k.  
& “Al-MexWood” sh.p.k. & “Eurondërtim 2000” sh.p.k.  
143.410.832 lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k.  
& “Garden Line” sh.p.k. & “Gjiguria” sh.p.k. 163.087.646 lekë, kualifikuar
4. “Gjoka Konstruksion” sh.p.k. 164.767.690 lekë, skualifikuar
5. “A.N.K.” sh.p.k. 164.789.829 lekë, skualifikuar
6. “Fusha” sh.p.k. 164.872.565 lekë, kualifikuar
7. “B 93” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
8. “Çaushi M” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
9. “Rosi” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Në datën 09.11.2015, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjiguria” sh.p.k. ka paraqitur ankim pranë AK duke kërkuar skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. dhe me vijimin e njoftimit të fituesit sipas vendimit të KVO datë 07.10.2015.

Në datën 16.11.2015 AK i ktheu përgjigje operatorit ekonomik ankimes duke mos e pranuar ankesën [...].

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si edhe pas shqyrtimit të informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjiguria” sh.p.k. se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk plotëson kriterin për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për muajin korrik 2015, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1, gërma “e”, përcaktohet se: “Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:[...]

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., ndërmjet shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geci” sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria “Curri” sh.p.k. merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria “Geci” sh.p.k. do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

III.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., në përmbushje të këtij kriteri rezulton se:

Shoqëria “Curri” sh.p.k. ka paraqitur:

*“Vërtetim debie” nr. 2452 prot, datë 28.08.2015, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “Curri” sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, ... rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 28.08.2015, pa përfshirë faturën koherente të muajit Korrik 2015”;*

Shoqëria “Geci” sh.p.k. ka paraqitur:

*“Vërtetim debie” nr. 6289 prot, datë 28.08.2015, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkesit “Geci” sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, ... rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 27.08.2015, duke përfshirë dhe faturën koherente të muajit Korrik 2015”.*

III.1.4. Në nenin 26, pika 7, gërma “c”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

III.1.5. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”

III.1.6. Në Kreun VII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.7. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.8. Sqarojmë se, referuar bazës ligjore si më sipër cituar si edhe kontratës së bashkëpunimit, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike përpara hapjes së ofertave, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga



autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kërkesa për pagesën e detyrimeve të energjisës elektrike nuk plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Konkretisht, rezulton se operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Nga dokumentacioni i mësipërm, i paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve, konstatohet se shoqëria “Curri” sh.p.k. rezulton të ketë të papaguar faturën e muajit Korrik 2015.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, është rasti të ritheksojë jurisprudencën e tij tashmë të konsoliduar në lidhje me kriterin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, se ai do t’i qëndrojë gjykimit që nëse një operator ekonomik rezulton me detyrime të papaguara për muajin më të fundit nisur nga muaji kur është zhvilluar procedura e prokurimit, atëherë ai nuk ka përmbushur kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik “Curri” sh.p.k., nuk e plotëson kriterin e lartpërmendur të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi procedura e prokurimit objekt ankimi është publikuar në datën 18.08.2015, dhe është zhvilluar në datën 17.09.2015.

Operatori ekonomik në fjalë, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, nuk ka vërtetuar se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, përfshirë edhe detyrimet për muajin Korrik 2015, data përfundimtare për shlyerjen e të cilëve, mbështetur në nenin e sipërcituar, ishte përkatësisht data 31.08.2015.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori ekonomik ankimes duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve *para hapjes së ofertave*.

Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. “Gjiguria” sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjiguria” sh.p.k. se *bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk plotëson kapacitetin teknik për mjetin special “makineri hidrombjellje, që do të thotë që nuk kanë një kontratë të vlefshme që plotëson kushtet ligjore të kontratës dhe specifikimet teknike në përputhje me punën që do të kryejë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2.4. “Kapaciteti teknik”, pika 2.4.5., është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

- a. Eskavator me zinxhir – 1 copë
- b. Eskavator me goma – 2 copë
- c. Fadrome me goma – 2 copë
- d. Minieskavator 2 deri 6 ton – 1 copë
- e. Kamion vetëshkarkues (kapaciteti 8-40 ton) – 12 copë
- f. Kamion vetëshkarkues (kapaciteti 3-8 ton) – 2 copë
- g. Rrula ngjeshes (kapaciteti 12-20 ton) – 1 copë
- h. Rrula ngjeshes (kapaciteti 10-12 ton) – 1 copë
- i. Rrul ngjeshes (kapaciteti 2-5 ton) – 1 copë
- j. Greidër – 1 copë
- k. Vibrator thellësie – 6 copë
- l. Kompresor
- m. Furçe mekanike për pastrim– 1 copë
- n. Autobot uji – 1 copë
- o. Gurëthyes, frontoje – 1 copë
- p. Impiant betoni – 1 copë
- q. Autobitumatriçe – 1 copë
- r. Asfalto-shtruese – 1 copë
- s. Makineri hidrombledhje – 1 copë

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 9 të DST duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

Për paisjet teknike dhe mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, nese jane ne pronesi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes (kur jane blere ne shqiperi) ose akt zhdoganimi dhe dokumenti qe verteton kryerjen e pageses (kur blerjet jane bere jashte shtetit). Kur paisjet jane marre me qera të paraqitet edhe kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe foto. Kur mjetet jane marre me qera të paraqitet edhe kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi”.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., ndërmjet shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geci” sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria “Curri” sh.p.k. merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria “Geci” sh.p.k. do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

Referuar zërave të preventivit të ndara ndërmjet operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. dhe “Geci” sh.p.k., rezulton se “Curri” sh.p.k. ka marrë përsipër ndërmjet të tjerave kryerjen e zërave të tillë si A – 2 Mbjellje pemë dhe gjelbërime, në të cilën përfshihen nënzërat si F.V. + shërbime hidrombjellje me varietete barishtore autoktone; Rrafshim skarpatesh, me

*krahë, në gjermim toke të butë; transport dheu me auto deri 5.0 km (largim dheu nga hapja e gropave dhe sjellje dheu për mbjellje); F.V. + shërbime Pinus Halepensis c. 20-25 cm; F.V. + shërbime Populus pyramidalis c. 20-25 cm; F.V. + shërbime Cupressus sempervirens pyramidalis h 5-6 m etj., ndërsa operatori ekonomik "Geci" sh.p.k. ka marrë përsipër kryerjen e zërave të tillë si D-1 Ohri Club, në të cilën përfshihen nënçerat si F.V. Gjeotekstil; F.V. + shërbime pinus nigra h. 550-600 cm; F.V. + shërbime Populus pyramidalis c. 20-25 cm; F.V. rërë plazhi (sipas specifikimeve); etj.*

Gjithashtu, deklarohet se emërohet përfaqësues i këtij bashkimi operatorësh shoqëria "Curri" sh.p.k.

III.2.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë rezulton se nga operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. dhe operatori ekonomik "Geci" sh.p.k. kanë paraqitur dokumentacionin në lidhje me mjetet dhe pajisjet përkatëse sipas kërkesës së përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.

Rezulton se nga operatori ekonomik "Curri" sh.p.k. nuk është paraqitur asnjë mjet makineri hidrombjellje referuar përqindjes dhe punëve të marra përsipër prej tij sipas kontratës së bashkëpunimit (*mbjellje pemë dhe gjelbërime, F.V. + shërbime hidrombjellje me varietete barishtore autoktone; Rrafshim skarpatesh, me krahë, në gjermim toke të butë; transport dheu me auto deri 5.0 km (largim dheu nga hapja e gropave dhe sjellje dheu për mbjellje); F.V. + shërbime Pinus Halepensis c. 20-25 cm; F.V. + shërbime Populus pyramidalis c. 20-25 cm; F.V. + shërbime Cupressus sempervirens pyramidalis h 5-6 m etj.*), ndërkohë që një mjet i tillë është paraqitur vetëm nga operatori ekonomik "Geci" sh.p.k.

III.2.4. Në Kreun VII, neni 74, "*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*", pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", parashikohet: "*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*".

III.2.5. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*".

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, përcaktohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*"

III.2.6. Sqarojmë se, referuar bazës ligjore si më sipër cituar si edhe kontratës së bashkëpunimit, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Geci" sh.p.k. nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kërkesa për makinerinë hidrombjellje, sipas përcaktimit të autoritetit kontraktor plotësohet vetëm nga operatori ekonomik "Geci" sh.p.k., ndërsa nga operatori ekonomik "Curri" sh.p.k., i cili ka marrë përsipër 50.75% të punimeve, kryerjen e punëve për të cilat nevojitet ky mjet, si edhe është lideri dhe përfaqësuesi ligjor i këtij bashkimi operatorësh, nuk plotësohet në përputhje me

përqindjen e tij dhe zërat e punëve që do të kryejë sipas kontratës së bashkëpunimit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, personelin e nevojshëm, pajisjet dhe makineritë, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Geci" sh.p.k., nuk plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me mjetin makineri hidrombjellje dhe nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Pe-Vla-Ku" sh.p.k. & "Garden Line" sh.p.k. & "Gjikuria" sh.p.k. qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Pe-Vla-Ku" sh.p.k. & "Garden Line" sh.p.k. & "Gjikuria" sh.p.k. se bashkimi i operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Geci" sh.p.k. nuk ka paraqitur taksat vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas QKR", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2.3. "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", pika 2.3.4., është përcaktuar kriteri: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet".

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Geci" sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Geci" sh.p.k., ndërmjet shoqërisë "Curri" sh.p.k. dhe shoqërisë "Geci" sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria "Curri" sh.p.k. merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria "Geci" sh.p.k. do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë të renditur në vendin e parë, rezulton se operatori ekonomik "Curri" sh.p.k., ka paraqitur Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", si edhe Ekstraktin Historik, sipas të dhënave të të së cilave në pikën 7 Zyra Qendrore e shoqërisë në Shqipëri deklarohet adresa Shkodër, Kopluk, Shkodër, ndërsa në pikën 14 Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit nuk deklarohet asnjë e dhënë tjetër adrese, ndërsa operatori ekonomik "Geci" sh.p.k., ka paraqitur Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", si edhe Ekstraktin Historik, sipas të dhënave të të së cilave në pikën 7 Zyra Qendrore e shoqërisë në Shqipëri deklarohet adresa Tiranë, Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr. 8, Tiranë, ndërsa në pikën 13 Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit deklarohet adresa Tiranë; Tiranë, Kashar, Katund i Ri, Park te zona kadastrale 2119, Nr. Pasurie 211/2/1.

III.3.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se ky bashkim operatorësh ekonomikë ka mangësi, pasi operatori ekonomik "Geci" sh.p.k. nuk ka paraqitur vërtetimin për pagesën e taksave vendore nga Komuna Kashar, Katund i Ri, ndërkohë që sipas ekstraktit të regjistrimit tregëtar dhe atij historik, përcaktuar në pikën 13 të këtij të fundit,

rezulton që ky operator ekonomik përveç zyrës qendrore, ka dhe ushtron aktivitet edhe në këto zona.

III.3.5. Në Kreun VII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

III.3.6. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .*”

III.3.7. Sqarojmë se, referuar bazës ligjore si më sipër cituar si edhe kontratës së bashkëpunimit, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk ka paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit si edhe në përputhje me përqindjen e marrë përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit.

Konkretisht, operatori ekonomik “Geci” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin e tij sipas ekstraktit të QKR-së (si më sipër përcaktuar në pikën III.3.4.), duke mos përmbushur kriterin për paraqitjen e vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve vendore për të gjitha vendet ku ushtron aktivitet sipas QKR të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k., për kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori ekonomik, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interesat e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. “Gjikuria” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-06670-08-18-2015, me objekt “Rehabilitimi i bregut të Liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës së segmentit Lin – Pogradec”, me fond limit 164.998.901 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Banka Botërore).
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. “Gjikuria” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1777 Protokolli**

**Datë 23.11.2015**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Zv/Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Spiro Kuro</b>	<b>Juliana Hoxha</b>	<b>Leonard Gremshi</b>	<b>Hektor Balluku</b>

**Kryetar**  
**Gentian Këri**

## Mendim Kundër

I. Unë, anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim K.P.P.), Juliana Hoxha nuk jam dakord me dispozitivin e vendimit dhe me arsyetimin e tij për sa i përket ankesës me objekt: “Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-06670-08-18-2015, me objekt “Rehabilitimi i bregut të Liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës së segmentit Lin – Pogradec”, me fond limit 164.998.901 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Banka Botërore).

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor,

### Arsyetoj

I.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjiguria” sh.p.k. se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk plotëson kriterin për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për muajin korrik 2015, vërej se:

I.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1, gërma “e”, përcaktohet se: “Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:[...] e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.

I.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., ndërmjet shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geci” sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria “Curri” sh.p.k. merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria “Geci” sh.p.k. do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

I.1.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., në përmbushje të këtij kriteri rezulton se:

Shoqëria “Curri” sh.p.k. ka paraqitur:

“Vërtetim debie” nr. 2452 prot, datë 28.08.2015, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “Curri” sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, ... rezulton të

*ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 28.08.2015, pa përfshirë faturën koherente të muajit Korrik 2015”;*

Shoqëria “Geci” sh.p.k. ka paraqitur:

*“Vërtetim debie” nr. 6289 prot, datë 28.08.2015, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “Geci” sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, ... rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 27.08.2015, duke përfshirë dhe faturën koherente të muajit Korrik 2015”.*

I.1.4. Sipas informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. në ankimin e paraqitur pranë autoritetit kontraktor për skualifikimin e padrejtë të ofertës së tij, ka paraqitur edhe shkresat nr. 2757/1 prot., datë 09.10.2015 dhe nr. 2757/2 prot., datë 13.10.2015, të lëshuara nga OSHEE Drejtoria Rajonale Shkodër, në të cilat citohet përkatësisht si më poshtë:

*“[...] Në vërtetimin e debisë së lëshuar me nr. 2452 prot., datë 28.08.2015 nga ana jonë përmban se subjekti rezulton 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datën 28.08.2015. Fatura e muajit Korrik 2015 është e drejtë ligjore e abonentit të likujdohet deri më 31.08.2015 prandaj abonenti nuk quhet debitor[...];*

*“[...] Vërtetim debie për operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik lëshuar me nr. 2452 prot., Shkodër, më 28.08.2015 subjekti Curri sh.p.k. me administrator z. F.C. rezulton 0 lekë detyrime për faturat e maturuara të energjisë elektrike, përfshirë muajin Korrik 2015, vlerë e llogaritur deri më 28.08.2015 [...]”.*

I.1.5. Në nenin 26, pika 7, gërma “c”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

*c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.*

I.1.6. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”*

I.1.7. Në Kreun VII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktohet shprehimisht se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat*



*ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

I.1.8. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

I.1.9. Sa më sipër cituar gjykoj se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi referuar shkresave të lëshuara nga OSHEE Drejtoria Rajonale Shkodër sipas kërkesës së bërë nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k., depozituar këto të fundit pranë autoritetit kontraktor bashkëlidhur me ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., kërkesa për pagesën e detyrimeve të energjisë elektrike plotësohet në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit nga i gjithë grupi i marrë së bashku.

Konkretisht, referuar dokumentacionit provues të paraqitur nga vetë operatori ekonomik pas hapjes së ofertave, rezulton se operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., i ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Nga dokumentacioni i mësipërm lëshuar nga OSHEE Drejtoria Rajonale Shkodër, konstatohet se shoqëria “Curri” sh.p.k. rezulton të ketë të paguar faturën e muajit Korrik 2015 dhe është me 0 lekë detyrime të papaguara, duke u vërtetuar kështu se ky operator është një abonent i rregullt në pagesat e energjisë elektrike dhe nuk konsiderohet debitor nga ana e organit kompetent OSHEE Drejtoria Rajonale Shkodër që verifikon shlyerjen e detyrime të tilla.

I.1.10. Operatorët ekonomikë në fjalë, anëtarë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., kanë vërtetuar se kanë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, përfshirë edhe detyrimet për muajin Korrik 2015, data përfundimtare për shlyerjen e të cilëve, mbështetur në nenin e sipërcituar, ishte përkatësisht data 31.08.2015, ndërkohë që procedura e prokurimit është zhvilluar në datën 17.09.2015.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, gjykoj se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike dhe konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. nuk qëndron.

II. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk plotëson kapacitetin teknik për mjetin special “makineri hidrombjellje, që do të thotë që nuk kanë një kontratë të vlefshme që plotëson kushtet ligjore të kontratës dhe specifikimet teknike në përputhje me punën që do të kryejë”, vërej se:

II.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2.4. “Kapaciteti teknik”, pika 2.4.5., është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

- a. Eskavator me zinxhir – 1 copë
- b. Eskavator me goma – 2 copë
- c. Fadrome me goma – 2 copë
- d. Minieskavator 2 deri 6 ton – 1 copë
- e. Kamion vetëshkarkues (kapaciteti 8-40 ton) – 12 copë
- f. Kamion vetëshkarkues (kapaciteti 3-8 ton) – 2 copë
- g. Rrula ngjeshes (kapaciteti 12-20 ton) – 1 copë
- h. Rrula ngjeshes (kapaciteti 10-12 ton) – 1 copë
- i. Rrul ngjeshes (kapaciteti 2-5 ton) – 1 copë
- j. Greidër – 1 copë
- k. Vibrator thellësie – 6 copë
- l. Kompresor
- m. Furçe mekanike për pastrim – 1 copë
- n. Autobot uji – 1 copë
- o. Gurëthyes, frontoje – 1 copë
- p. Impiant betoni – 1 copë
- q. Autobitumatriçe – 1 copë
- r. Asfalto-shtruese – 1 copë
- s. **Makineri hidrombledhje – 1 copë**

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 9 të DST duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

Për paisjet teknike dhe mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, nese jane ne pronesi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes (kur jane blere ne shqiperi) ose akt zhdoganimi dhe dokumenti qe verteton kryerjen e pageses (kur blerjet jane bere jashte shtetit). Kur paisjet jane marre me qera të paraqitet edhe kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe foto. Kur mjetet janë marre me qera të paraqitet edhe kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi”.*

II.1.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti *Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.*, ndërmjet shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geci” sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria “Curri” sh.p.k. merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria “Geci” sh.p.k. do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

Referuar zërave të preventivit të ndara ndërmjet operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. dhe “Geci” sh.p.k., rezulton se “Curri” sh.p.k. ka marrë përsipër ndërmjet të tjerave kryerjen e zërave të tillë si *A – 2 Mbjellje pemë dhe gjelbërime, në të cilën përfshihen nënzërat si F.V. + shërbime hidrombjellje me varietete barishtore autoktone; Rrafshim skarpatesh, me krahë, në gjërmim toke të butë; transport dheu me auto deri 5.0 km (largim dheu nga hapja e gropave dhe sjellje dheu për mbjellje); F.V. + shërbime Pinus Halepensis c. 20-25 cm; F.V. + shërbime Populus pyramidalis c. 20-25 cm; F.V. + shërbime Cupressus sempervirens pyramidalis h 5-6 m etj.*

Rezulton se “Geci” sh.p.k. ka marrë përsipër kryerjen e zërave të tillë si *D-1 Ohri Club, në të cilën përfshihen nënzërat si F.V. Gjeotekstil; F.V. + shërbime pinus nigra h. 550-600 cm; F.V. + shërbime Populus pyramidalis c. 20-25 cm; F.V. rërë plazhi (sipas specifikimeve); etj.*

II.1.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë rezulton se nga operatori ekonomik “Geci” sh.p.k. si pjesë e bashimit të operatoreve ekonomikë “Curri” sh.p.k. dhe “Geci” sh.p.k sipas zërave të preventivit të punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik është paraqitur dokumentacioni në lidhje me disponimin e mjetit makineri hidrombjellje 1 copë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit.

II.1.3. Në Kreun VII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

II.1.4. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe*

*përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

II.1.5. Referuar sa më sipër, rezulton se të dy operatorët ekonomikë sipas kontratës së bashkëpunimit kanë marrë përsipër të kryejnë furnizime, vendosje dhe shërbime pemësh e bimësh etj. Në të tilla kushte kur nga të dy operatorët ekonomikë janë marrë përsipër të kryhen mbjellje pemë, bimë etj, dhe në kushtet kur nga autoriteti kontraktor **është kërkuar një mjet makineri hidrombjellje**, vlerësoj se bashkimi i operatorëve ekonomikë i marrë së bashku e plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Operatorët ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. kanë marrë përsipër së bashku realizimin e punimeve të preventivit të përcaktuar në dokumentat e tenderit duke garantuar zbatimin me sukses të kontratës, ndërkohë që ofron edhe vlerën më të ulët - që janë e duhet të jenë edhe qëllimet kryesore në një procedurë prokurimi. Qëllimi i bashkimit të operatorëve është në vetvete realizimi dhe kryerja me sukses i kontratës së prokurimit.

Për sa më sipër, gjykoj se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me mjetin makineri hidrombjellje dhe konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjiguria” sh.p.k. nuk qëndron.

III. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjiguria” sh.p.k. se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk ka paraqitur taksat vendore për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas QKR vërej se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2.3. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.3.4., është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet”.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., ndërmjet shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geci” sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria “Curri” sh.p.k. merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria “Geci” sh.p.k. do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë të renditur në vendin e parë, rezulton se operatori ekonomik “Curri” sh.p.k., ka paraqitur Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, si edhe Ekstraktin Historik, sipas të dhënave të të së cilave në pikën 7 Zyra Qendrore e shoqërisë në Shqipëri deklarohet adresa *Shkodër, Koplík, Shkodër*, ndërsa operatori ekonomik “Geci” sh.p.k., ka paraqitur Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, si edhe Ekstraktin Historik, sipas të dhënave të të së cilave në pikën 7 Zyra Qendrore e shoqërisë në Shqipëri deklarohet adresa *Tiranë, Tirana International Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr. 8, Tiranë*.

III.1.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij bashkimi operatorësh rezulton se është paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. dokumenti *Vërtetim* nga Bashkia Koplík, në të cilën sipas ekstraktit të QKR ky operator ekonomik ka zyrën qendrore, ndërsa nga operatori ekonomik “Geci” sh.p.k. është paraqitur dokumenti *Vërtetim* nga Bashkia Tiranë, në të cilën sipas ekstraktit të QKR ky operator ekonomik ka zyrën qendrore, pra nga secili operator anëtar i bashkimit të mësipërm të operatorëve ekonomikë është paraqitur dokumentacioni i lëshuar nga organet e pushtetit vendor në lidhje me pagesën e taksave vendore në ato vende ku këta të fundit ushtrojnë aktivitet tregëtar.

III.1.5. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .*”

III.1.6. Sa më sipër analizuar vlerësoj se, bashkimi i operatorëve ekonomikë operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. ka paraqitur ofertë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi ky operator ka paraqitur dokumentacion në lidhje me shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin e tij sipas ekstraktit të QKR-së, duke përmbushur kriterin për paraqitjen e vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve vendore të përcaktuar tek *Kapaciteti ekonomik dhe financiar* në dokumentat e tenderit, si një grup i marrë së bashku.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe mund të konsiderohet i vlefshëm

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. se anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk disponojnë mjetet në përputhje me punën që kanë marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit”, vërej se:

III.2.1 Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2.4. “Kapaciteti teknik”, pika 2.4.5., është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

- a. Eskavator me zinxhir – 1 copë
- b. Eskavator me goma – 2 copë
- c. Fadrome me goma – 2 copë
- d. Minieskavator 2 deri 6 ton – 1 copë
- e. Kamion vetëshkarkues (kapaciteti 8-40 ton) – 12 copë
- f. Kamion vetëshkarkues (kapaciteti 3-8 ton) – 2 copë
- g. Rrula ngjeshes (kapaciteti 12-20 ton) – 1 copë
- h. Rrula ngjeshes (kapaciteti 10-12 ton) – 1 copë
- i. Rrul ngjeshes (kapaciteti 2-5 ton) – 1 copë
- j. Greidër – 1 copë
- k. Vibrator thellësie – 6 copë
- l. Kompresor
- m. Furçe mekanike për pastrim – 1 copë
- n. Autobot uji – 1 copë
- o. Gurëthyes, frontoje – 1 copë
- p. Impiant betoni – 1 copë
- q. Autobitumatriçe – 1 copë
- r. Asfalto-shtruese – 1 copë
- s. Makineri hidrombledhje – 1 copë

Për të dëshmuar këtë, Formulari i shtojcës 9 të DST duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

Për paisjet teknike dhe mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, nese jane ne pronesi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes (kur jane blere ne shqiperi) ose akt zhdoganimi dhe dokumenti qe verteton kryerjen e pageses (kur blerjet jane bere jashte shtetit). Kur paisjet jane marre me qera të paraqitet edhe kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe foto. Kur mjetet jane marre me qera të paraqitet edhe kontrata përkatëse e qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi”.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti *Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.*, ndërmjet shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geci” sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria “Curri” sh.p.k. merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria “Geci” sh.p.k. do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

III.2.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë rezulton se “Curri” sh.p.k. dhe “Geci” sh.p.k. ka paraqitur dokumentacion se disponon makineritë eskavator me zinxhir; eskavator me goma; fadrome me goma; minieskavator 2 deri 6 ton; kamion vetëshkarkues (kapaciteti 8-40 ton); kamion vetëshkarkues (kapaciteti 3-8 ton); rrula ngjeshes (kapaciteti 12-20 ton); rrula ngjeshes (kapaciteti 10-12 ton); rrul ngjeshes (kapaciteti 2-5 ton); greidër; vibrator thellësie; kompresor; furçe mekanike për pastrim; autobot uji; gurëthyes, frontoje; impiant betoni; autobitumatriçe; asfalto-shtruese; makineri hidrombledhje, shoqëruar të gjitha me dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.2.4. Në Kreun VII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

III.2.5. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .*”

Ndërsa në pikën 2 të nenit 55 të po këtij ligji përcaktohet se “*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit....*”

III.2.6. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta,

në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, gjykoj se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. me dokumentacionin e dorëzuar vërteton se e plotëson kriterin për kualifikim të vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën Shtojca 10, pika 2.4. “Kapaciteti teknik”, pika 2.4.5., të dokumentave të tenderit, pasi disponon kapacitetet teknike në lidhje me makineritë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, duke e përmbushur atë si një grup i marrë së bashku në përputhje me zërat e punimeve të marra përsipër.

Për sa më sipër, vlerësoj se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me makineritë dhe pajisjet dhe konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk plotëson kapacitetin teknik për punonjësit, pasi stafi i paraqitur nuk është në përputhje me punimet e marra përsipër nga secili operator dhe nuk është i regjistruar në kompaninë respektive, mungojnë diplomat, kontratat e punës dhe CV”, vërej se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2.4. “Kapaciteti teknik”, pika 2.4.3., është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij minimalisht:

2 (dy) inxhinier ndërtimi

1 (një) arkitekt ose urbanist

1 (një) inxhinier mekanik

1 (një) inxhinier hidroteknik

1 (një) inxhinier elektrik

1 (një) inxhinier pyjesh ose agronom

1 (një) inxhinier gjeolog

1 (një) inxhinier topograf

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin diplomat, kontratat e punës dhe cv përkatëse”.



III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti *Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.*, ndërmjet shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geci” sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria “Curri” sh.p.k. merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria “Geci” sh.p.k. do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

Referuar zërave të preventivit të ndara ndërmjet operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. dhe “Geci” sh.p.k. rezulton se bazuar në preventivin e hartuar dhe publikuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, shoqëria “Curri” sh.p.k. ka marrë përsipër ndërmjet të tjerave kryerjen e zërave të tillë si *A-1, A-2, D-1 nga zëri 37 e deri në fund, E-1, F-1*, ndërsa shoqëria “Geci” sh.p.k. ka marrë përsipër kryerjen e punimeve *D-1 deri te zëri 37*, referuar preventivit të hartuar dhe publikuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

III.3.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij bashkimi operatorësh ekonomikë rezulton se Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. ka deklaruar stafin përgjegjës për realizimin e punimeve të parashikuara përkatësisht:

- Inxhinier ndërtimi shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;
- Inxhinier arkitekt shoqëruar me kontratë dhe diplomë;
- Inxhinier mekanik shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;
- Inxhinier hidroteknik shoqëruar me listën e notave, diplomë dhe CV;
- Inxhinier elektrik, i shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;
- Inxhinier gjeolog shoqëruar me kontratë dhe diplomë;
- Inxhinier topograf shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;
- Inxhinier mjedisi shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV

Operatori ekonomik “Geci” sh.p.k. ka deklaruar stafin përgjegjës për realizimin e punimeve të parashikuara:

- Inxhinier ndërtimi shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;
- Inxhinier mekanik shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;
- Inxhinier elektrik, i shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;
- Inxhinier pyjesh, i shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;
- Inxhinier gjeolog shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;
- Inxhinier markshaidër (topograf) shoqëruar me kontratë, diplomë dhe CV;

III.3.4. Në Kreun VII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

III.3.5. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.3.6. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se *komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, gjykoj se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. me dokumentacionin e dorëzuar vërteton se e plotëson kriterin për kualifikim të vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën Shtojca 10, pika 2.4. “Kapaciteti teknik”, pika 2.4.3., të dokumentave të tenderit, duke vërtetuar se disponon kapacitetet teknike në lidhje me personelin sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, duke e përmbushur atë si një grup i marrë së bashku.*

Për sa më sipër, gjykoj se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k., plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me stafin drejtues dhe konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. se *bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk ka paraqitur formularët e vlerësimit sipas shtojcës 8*, vërej se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2.4. “Kapaciteti teknik”, pika 2.4.1., është përcaktuar kriteri:

*“Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 82.500.000 (tetëdhjetë e dy million e pesëqind mijë) Lekë (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 330,000,000 (treqind e tridhjetë milion) Lekë (pa TVSH).*

*Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë formularët e vlerësimit sipas shtojcës përkatëse të DST të shoqëruar me kontratën/kontratat e nënshkruara nga palët, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore përkatëse. Kur kontratat janë realizuar si bashkim shoqëror, të paraqitet edhe marreveshja e bashkëpunimit”.*

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. rezulton se është paraqitur dokumenti *Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.*,

ndërmjet shoqërisë “Curri” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geci” sh.p.k., në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria “Curri” sh.p.k. merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria “Geci” sh.p.k. do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

III.4.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë rezulton se: Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k. dhe operatori ekonomik “Geci” sh.p.k. kanë paraqitur disa formularë vlerësimi (Shtojca 8), për kontratat e paraqitura, në përputhje me kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, duke vërtetuar se e përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor.

III.4.4. Në Kreun VII, neni 74, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, parashikohet: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*”.

III.4.5. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .*”

III.4.6. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta,

në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se *komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit*, gjykoj se bashkimi i operatorëve ekonomikë *“Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.* me dokumentacionin e dorëzuar vërteton se e plotëson kriterin për kualifikim të vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me paraqitjen e Shtojcës 8 – Formulari i Vlerësimit, secili sipas kontratave të paraqitura.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë *“Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k.* nuk qëndron.

III.4.7. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë *“Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k.* se *bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. nuk ka paraqitur deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas shtojcës 9*”, vërej se:

III.4.8. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10, pika 2 *Kriteret e veçanta të kualifikimit* gërma *“dh”* është përcaktuar: *“dh. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9”*.

III.4.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë *“Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.* rezulton se është paraqitur dokumenti *Kontratë bashkëpunimi e përkohshme e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.*, ndërmjet shoqërisë *“Curri” sh.p.k.* dhe shoqërisë *“Geci” sh.p.k.*, në të cilën është përcaktuar ndarja e punimeve në përqindje, nga ku shoqëria *“Curri” sh.p.k.* merr përsipër 50.75 % të kuotave të përfaqësimit në objektin e mësipërm dhe shoqëria *“Geci” sh.p.k.* do të përfaqësojë 49.25 % të kuotave në objektin e mësipërm.

III.4.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë *“Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k.* rezulton se nga secili operator ekonomik anëtar i bashkimit të mësipërm është paraqitur dokumenti *Shtojca 9 “Mbi disponimin e makinerive e pajisjeve”*, në të cilat janë deklaruar makineritë e pajisjet përkatëse që disponon secili për realizimin e punimeve të marra përsipër, duke vërtetuar se e përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor.

III.4.11. Në Kreun VII, neni 74, *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”*, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.4.12. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.4.13. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, gjykoj se nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k. & “Geci” sh.p.k. me dokumentacionin e dorëzuar vërtetohet se plotësohet kërkesën për paraqitjen e shtojcës 9 në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve.

Rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. nuk qëndron.

III.5 Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë për zhvillimin jo të rregullt të procedurës së mësipërme të prokurimit, në lidhje me afatet për procesin e vlerësimit dhe rivlerësimit, sqaroj se referuar informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton si më poshtë:

Në datën 12.09.2015 është zhvilluar procedura e prokurimit dhe në datën 07.10.2015 nëpërmjet sistemit elektronik ofertuesit janë njoftuar për klasifikimin përfundimtar, i cili rezulton si më poshtë:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Curri” sh.p.k.  
& “Geci” sh.p.k. 128.639.120 lekë, skualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bajrami N” sh.p.k.  
& “Al-Mex Wood” sh.p.k. & “Eurondërtim 2000” sh.p.k. 143.410.832 lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k.  
& “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k. 163.087.646 lekë, kualifikuar
4. “Gjoka Konstruksion” sh.p.k. 164.767.690 lekë, skualifikuar
5. “A.N.K.” sh.p.k. 164.789.829 lekë, skualifikuar

- |                       |                                   |
|-----------------------|-----------------------------------|
| 6. "Fusha" sh.p.k.    | 164.872.565 lekë, kualifikuar     |
| 7. "B 93" sh.p.k.     | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 8. "Çaushi M" sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 9. "Rosi" sh.p.k.     | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

Në datën 12.10.2015 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Geci" sh.p.k. & "Curri" sh.p.k. paraqiti ankimi pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit.

Në datën 16.10.2015 autoriteti kontraktor i ktheu përgjigje ankimuesit duke e pranuar ankesën.

Në datën 20.10.2015 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, mbështetur në Vendimin e Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesave vendosi të konsiderojë të kualifikuar bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Geci" sh.p.k.

KVO bëri kontrollin e veprimeve aritmetike të preventivit dhe konstatoi se nuk ka gabime aritmetike. Më pas KVO kontrolloi për oferta anomalisht të ulta.

[...]

KVO me unanimitet vendosi të njoftojë bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Geci" sh.p.k. të paraqesin argumentimet për ofertën anomalisht të ulët të paraqitur në tender, i cili është njoftuar në datën 21.10.2015 të paraqesë argumentimet e tij brenda datës 26.10.2015 ora 15.30, për ofertën anomalisht të ulët.

Në datën 05.11.2015 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave shqyrtoi argumentimet e paraqitura nga bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k. & "Geci" sh.p.k. dhe konstatoi se argumentat e dhëna janë të mjaftueshme.

Pas rivlerësimit, në datën 06.11.2015 është dhënë rezultati përfundimtar i kualifikimeve si më poshtë vijon:

- |   |                                   |
|---|-----------------------------------|
| 1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Curri" sh.p.k.<br>& "Geci" sh.p.k.   | 128.639.120 lekë, kualifikuar     |
| 2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Bajrami N" sh.p.k.<br>& "Al-Mex Wood" sh.p.k. & "Eurondërtim 2000" sh.p.k. | 143.410.832 lekë, skualifikuar    |
| 3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Pe-Vla-Ku" sh.p.k.<br>& "Garden Line" sh.p.k. & "Gjiguria" sh.p.k.         | 163.087.646 lekë, kualifikuar     |
| 4. "Gjoka Konstruksion" sh.p.k.   | 164.767.690 lekë, skualifikuar    |
| 5. "A.N.K." sh.p.k.   | 164.789.829 lekë, skualifikuar    |
| 6. "Fusha" sh.p.k.  | 164.872.565 lekë, kualifikuar     |
| 7. "B 93" sh.p.k.   | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 8. "Çaushi M" sh.p.k.   | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 9. "Rosi" sh.p.k.   | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

Sa më sipër, referuar informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor gjykoj se ky i fundit ka të dokumentuar dhe argumentuar sipas afateve të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, të gjitha hapat e ndjekura në lidhje me procesin e vlerësimit, ankimimit dhe rivlerësimit.

Rrjdhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përfundimisht, nisur nga argumentat e parashtruara mësipër gjykoj se Komisioni i Prokurimit Publik duhet të rrëzonte ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. & “Garden Line” sh.p.k. & “Gjikuria” sh.p.k.

Vlerësoj se Komisioni i Prokurimit Publik duhet të jetë garant i respektimit të ligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomike, vlerësimin efikas dhe objektiv të ankesave duke shmangur subjektivizmin në vlerësimin tërësor të dokumentacionit tekniko-ligjor të depozituar nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, mbajtur në konsideratë ofertat me cmime konkurruese që demonstronë të gjitha garancitë financiare dhe ligjore për realizimin me sukses të kontraktës objekt prokurimi.



**Anëtare  
Juliana Hoxha**